



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Komisioni i Apelimit

Nr. 20 Prot

Shkodër, më 20.06.2024

VENDIM

Nr. 7

Datë: 20.06.2024

Komisioni i Apelimit, në mbledhjen e tij të datës 20.06.2024, bazuar në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në U.SH", neni 36, pika 6, si dhe në nenin 1 të Rregullores së Komisionit të Apelimit, shqyrtoi ankimimin me nr. prot. 13 të Znj. Albana Boriçi, ankimimi nr. prot. 14 të Z. Arben Prendi, ankimimi nr. prot. 17 të Znj. Blerta Dragusha dhe ankimimi nr. prot. 18 të Znj. Ermira Kalaj për vendimin e KIZ me nr. 20 të dt. 17.06.2024, për fletët e votimit. K.A arsyeton që një fletë votimi e tillë, që është dhe praktikë e mëparshme, i jep të drejtë votuesit për të shprehur vullnetin e tij të plotë ndaj çdo kandidati për anëtar të Senatit Akademik. Shfuqizimi i këtij vendimi do të dëmtonte vullnetin e votuesve veçanërisht në rastet kur kemi aq kandidat sa vende në Senatit Akademik. Komisioni i Apelimit, me tre vota pro dhe dy vota kundër:

VENDOS

1. Lënien në fuqi të vendimit të KIZ, me nr. 20, datë 17.06.2024
2. Ky vendim publikohet në mjediset zyrtare publike të K.A dhe në faqen zyrtare të U.SH
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare**

Arselida Mashaj

**Sekretare**

Ambra Kokaj

**Anëtar**

Hajrije Dibra

Sereta Koperaj

Arjeta Anamali